

MACHT TIEFGRUND WASSER



PËRSHKRIMI

Astar akrilik universal me bazë uji me veti të shkëlqyera depërtuese që ofron ngjitje dhe izolim perfekt

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Hollimi 1:1
- Ngjyra bojëqielli
- Shkallë hapjeje 250m²
- Ngjitje shumë e fortë dhe tharje e shpejtë
- Sipërfaqe e shkëlqyeshme për të gjitha llojet e bojrave me bazë uji si dhe uniforme në dorën e fundit
- Aplikim i lehtë, depërtim i lartë dhe normë e lartë e përhapjes

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Përdoret në të gjithë muret dhe tavanët e brendshëm, të rinj, të vjetër dhe të lyer më parë me bojë, për lyerjen e çdo lloj ambienti të brendshëm, dhoma gjumi, tualete, dhoma ndenjeje, ambiente zyrash, shërbimesh etj. Gjithashtu sugjerohet të aplikohet në fasada të jashtme.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	Kopolimer akrilik
Densiteti EN ISO 2811-1	1,15±0,02 gr/ml
Mbetja e thatë EN ISO 3251	40%
Shkalla e hollimit	50 – 100%
Viskoziteti	35 ± 5 KU
Koha e tharjes mes dy shtresave	2 - 4 orë
VOC në produktin e gatshëm (Di rektiva Europiane 2004/42/EC) (g/l)	≤ 10
VOC emetimi në ambient, dhomë simulimi ISO 16000 (mg/m3)	≤ 0.2

UDHËZIME APLIKIMI

- Metoda e aplikimit: Furçë, rrul ose me sprucim.
- Hollimi: Rekomandohet të hollohet me 100% ujë.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqet duhet të jenë të thara plotësisht, të pastra dhe pa elemente që pengojnë ngjithmërinë e bojës. Riparoni të gjitha plasaritjet dhe pjesët e dëmtuara duke përdorur produktet e linjës Deutschcolor, Vox 707, Glatte Spachtel, Spachtel Finish, etj.

PAKETIMI

1 lt, 5 lt, 10 lt

RUAJTJA

36 muaj nëse ruhet në një vend të thatë, larg burimeve të nxehtësisë, në një temperaturë midis +5°C dhe +30°C. Mbrojeni nga ngrica.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

SHËNIME

- Në sipërfaqe të betonit të freskët produkti rekomandohet të aplikohet të paktën pas 30-40 ditësh.
- Rekomandohet të shmangni aplikimin e produktit në temperatura nën 5°C ose pak para shiut.

